



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

---

Numri i lëndës: 2019:147901

Datë: 12.02.2024

Numri i dokumentit: 05313591

P.nr.4473/18

GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Dibran Jusufi, në çështjen penale kundër të pandehurit K.G., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (Kodi Nr.04/L-082), i akuzuar sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1276/2018 të datës 24.10.2018, jashtë seancës, më datë 12.02.2024, mori dhe përpiloi këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET aktakuza e Prokurorisë Themelore në Prishtinë – Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1276/2018 të datës 24.10.2018 dhe PUSHOHET procedura penale ndaj të pandehurit K.G., nga i ati B., nëna H., e gjinisë B., i lindur me ....., në ....., ku edhe tani jeton në rrugën “....”, p.nr., me numër personal ....., shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës, i akuzuar për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së, pasi që ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale.

II. Në bazë të nenit 276 të KPPRK-ës nga i pandehuri konfiskohet substanca narkotike e llojit “Marihuanë” në peshë prej 0.82 gram. Pas plotfuqishmërisë së këtij aktvendimi, kjo substancë narkotike duhet të shkatërrohet nga Policia e Kosovës, në bashkëpunimin me institucionet tjera relevante, sipas procedurave standarde në fuqi.

III. Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të kësaj gjykate.

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Prishtinë, pranë kësaj gjykate me datë 24.10.2018, ka paraqitur aktakuzën PP.II.nr.1276/2018 të datës 24.10.2018, kundër të pandehurit K.G., për shkak të veprës penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së.

Gjyqtari i çështjes pas vlerësimit të shkresave të lëndës, e duke vepruar sipas detyrës zyrtare, konstatoi se në këtë çështje penale ka arritur afati kohor i parashkrimit absolut të ndjekjes penale për të pandehurin. Nga shkresat e lëndës rezulton se i pandehuri akuzohet për veprën penale Posedimi i paautorizuar i narkotikeve, substancave psikotrope ose analoge nga neni 275 par. 1 të KPRK-së (i cili ishte në fuqi gjatë kohës së kryerjes së veprës penale të pretenduar), për të cilën parashihet dënohet me gjobë dhe me burgim prej një (1) deri në tre (3) vjet. Sipas dispozitës së nenit 106 par. 1 pika 1.5 të KPRK-së, për vepër penale të dënueshme me më shumë se një (1) vit burgim, ndjekja penale nuk mund të ndërmerret nëse kanë kaluar 3 (tri) vite, nga koha e kryerjes së veprës penale apo nga veprimi i fundit procedural, (parashkrimi relativ), kurse sipas dispozitës së nenit 107 par. 8 të KPRK-së ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (ndalesa absolute mbi ndjekjen penale).

Bazuar në dënimin që parashihet për këtë vepër penale, rezulton se në rastin konkret ka arritur parashkrimi absolut i ndjekjes penale, pasi që nga shkresat e lëndës, si dhe nga përshkrimi si në aktakuzë, del se vepra penale pretendohet se është kryer me datë 07.02.2018, në anën tjetër në kuptim të nenit 107 par. 1 të KPRK-së afati i parashkrimit të ndjekjes penale fillon të rrjedh nga dita kur është kryer vepra penale. Në rastin konkret duke pasur parasysh se nga koha e kryerjes së veprës penale ka kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit, prej kohës së kryerjes së veprës penale të pretenduar, e deri në ditën e përpilimit të këtij aktvendimi kanë kaluar më shumë se gjashtë (6) vite, respektivisht në këtë çështje penale afati i parashkrimit absolut të ndjekjes penale ka arritur me datë 21.02.2024, prandaj edhe u vendos sikurse në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Gjykata duke u bazuar në dispozitën e nenit 276 par. 1 dhe 2 të KPP-së, ka urdhëruar konfiskimin e detyrueshëm dhe të përhershëm të substancës narkotike e llojit Marihuanë me peshë prej 2.5 gram, e sekuestruar nga i akuzuari pasi që e njëjta substancë narkotike e lartcekur bënë pjesë në sendet që konfiskohen në mënyrë automatike, andaj gjykata ka vendosur të konfiskoj përherë

këtë sasi të narkotikëve, si dhe ka urdhëruar shkatërrimin e saj, pasi që ekziston baza ligjore për konfiskimin e përhershëm të substancës narkotike, ashtu siç përcaktohet me nenin 276 të KPP-së, që rregullon konfiskimin e detyrueshëm.

Vendimin për shpenzimet e procedurës penale, gjykata e mori konform nenit 453 par.1 të KPP-së.

Duke e marrë parasysh faktin se ekzistojnë rrethana të cilat pengojnë ndjekjen penale, konform nenit 106 par.1 nën par. 1.6 dhe nenit 107 par.8 të KPRK-së dhe nenit 357 par.1 nënpar.1.3 të KPP-së, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

### GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË

Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal

P.nr.4473/18 datë 12.02.2024

Gjyqtari i vetëm gjykues,

Dibran Jusufi

---

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa në afat prej tri (3) ditëve prej ditës së pranimit të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate, për Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë.